



VENDIM

Nr. 92 Datë 26.09.2011

**PËR
SHTYRJEN E AFATIT TË LIÇENSËS NR. 63 TË DHËNË ME
VENDIM TË BORDIT TË KOMISIONERËVE NR. 89, DATË
06.08.2008, I NDRYSHUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË
KOMISIONERËVE NR. 19, DATË 08.03.2010, PËR “ALBANIAN
GREEN ENERGY”**

Në mbështetje të neneve 9, 13 pika 1, gërma “a”, dhe 15 të Ligjit Nr.9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neneve 121 dhe 128 të Ligjit nr.8485, datë 12.05.2008 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 26.09.2011, mbasi shqyrtoi informacionin e Drejtorisë së Licensimit dhe Monitorimit të Tregut për shtyrjen e afateve për realizimin e kushteve të vendosura nga ERE shoqërisë “ALBANIAN GREEN ENERGY” sh.p.k,

Dhe duke konsideruar :

Kompleksitetin e problematikes që i licensuari ka hasur për fillimin e punimeve për ndërtimin e centraleve, TEC me biomasë të lëngshme, për shkak se ende nuk ka marrë autorizimin final të ndërtimit të kësaj linje nga Ministria e Ambientit dhe Mbrojtjes së Territorit të Detit në Itali, duke qënë se ndërtimi i linjave të interkonjeksionit, përveç etapave administrative në të cilat kalon çdo projekt përben akoma një teknologji jo shumë të njohur në vend dhe që kërkon asistencën teknike të huaj,

Për gjithë sa më sipër Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi:

1. Në vendimin nr.89, datë 06.08.2008, për dhenien e licensës shoqërisë ”Albanian Green Energy” sh.p.k në aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike me erë dhe prodhimin e energjisë elektrike, (Bllok motore - gjeneratorë të ushqyer me biomasë të lëngshme Shëngjin, Lezhë) të bëhen këto ndryshime:

Pika 1 gërma “d” të ndryshohet si më poshtë:

d.1. Afati i fillimit të punimeve për realizimin e projektit do të jetë në përputhje të afatit të përcaktuar në lejen e METE-s nr. 4/1, datë 07.12.2009, të miratuar me VKM nr. 31, datë 20.01.2010, të ndryshuar më VKM-në nr. 542, datë 27.07.2011, për ndërtimin e Linjës Tregëtare të Interkonjeksionit me rrymë të vazhduar ndërmjet Kallmet/Lezhë dhe Zapponeta/Manfredonia.

d.2. Koha e zbatimit të gjithë projektit përfshirë dhe kolaudimin e veprës do të jetë 36 muaj nga realizimi i afatit të përcaktuar në pikën d.1.

2. Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë shoqërinë “Albanian Green Energy” për Vendimin e Bordit të Komisionereve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.